

## KERKESE PER SHPREHJE INTERESI BKT2023RBD002

---

Gjetje ambienti me qira për Degën Ibrahim Rrugova

Afati i fundit i dergimit të shprehjes së interesit: 30 Nëntor 2023, 12:00 p.m

Tiranë, 10/11/2023

Nr. Prot:

**Subjekti: Ftesë për për shprehje interesi Ref. BKT2023RBD002**

E nderuar Kompani,

BKT për nevoja dhe interesa të punës së saj shpreh interesin për gjetjen e një ambienti me qira për alokimin e Degës Ibrahim Rugova. Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj sipas specifikimeve bashkangjitur. Ne do të bashkëpunojmë me ofertuesin që ofron kushtet më të mira për bankën sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ftesë për shprehje interesi.

**Objekti i Ftesës për Ofertë:**

**Gjetje ambienti me qira për alokimin e Degës Ibrahim Rugova**

BKT, si banka më e madhe që operon në Republikën e Shqipërisë, është e interesuar për gjetjen e një ambienti me qira për degë. Siperfaqja e kërkuar e ambientit 150-200 m<sup>2</sup>.

Ambjenti kërkohet të jetë i pozicionuar në zonat :

- Rruga e Kavajës ( nga Volkswagen deri ne Qëndër);
- Blvd Zogu i Parë ( nga kryqëzimi me rrugen Fortuzi deri ne Qëndër);
- Rruga Luigi Gurakuqi ( nga Pazari i Ri deri ne Qëndër);
- Rruga e Dibres ( nga Selvia deri ne Qëndër);
- Rruga e Barrikadave ( nga kryqëzimi me rrugën Fortuzi deri ne Qëndër);
- Shetitorja Murat Toptani ( nga Xhamia e Namasgjase deri ne Qëndër);
- Rruga Ibrahim Rugova ( nga Ura e Shallvareve deri ne Qëndër);
- Blvd Gjergj Fishta ( nga Ura e Shallvareve deri tek Bar Corner);
- Rruga Myslym Shyri ( nga ish dygan Adiddas deri tek Taiwani);
- Blvd Deshmorët e Kombit ( nga Korpus deri ne Qëndër);
- Rruga e Durrësit ( nga kryqëzimi me rrugen Fortuzi deri ne Qëndër).

Kontrata e qirase do të jetë 10 vjecare.

**Dokumentacioni i nevojshëm:**

Oferta duhet të shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm ekonomik (*Aneks 1*), teknik, si edhe një prezantim të shkurtër të ambientit. I detyrueshëm është dokumentacioni si më poshtë:

- Certifikata për vërtetim pronësie lëshuar nga ZRPP Tiranë apo Kontrata e pronësisë;
- Planimetria e ambientit;
- Kontrata të OSHEE dhe UKT;
- Foto të ambientit ( brenda dhe jashtë ).

**Dorëzimi i ofertës:** Oferta juaj, në formatin e kërkuar, duhet të dërgohet në adresën e-mail: [procurement@bkt.com.al](mailto:procurement@bkt.com.al) ose me zarf të mbyllur me mbishkrimin e mëposhtëm të vetëm në zarf, të prerë e të ngjitur nga kjo ftesë për ofertë, të adresohet dhe paraqitet tek:

**Në përgjigje të :Ref. BKT2023RBD002**

**Departamenti i Prokurimeve**

**Banka Kombëtare Tregtare**

**Rruga e Vilave, Lunder 1, Drejtoria e Përgjithshme**

**Tiranë, Shqipëri**

Për çdo pyetje, paqartësi apo vizitë në objekt mund të kontaktoni në adresën e-mail: [procurement@bkt.com.al](mailto:procurement@bkt.com.al), por jo më vonë se 5 ditë pune nga afati përfundimtar i dorëzimit të ofertave.

**Vlefshmëria e Ofertës:** Oferta juaj do të jetë e vlefshme për një periudhë të përcaktuar jo më pak se 3 muaj.

**Formati i ofertës:** Ju duhet të respektoni formatin e kësaj ftese për shpreje interesi në rast të kundërt oferta do të konsiderohet e pavlefshme.

Kontraktuesi është i vetmi përgjegjës për ekzekutimin e kontratës që rezulton nga kjo kërkesë për ofertë. Fakti që BKT i lejon kontraktorit të nënkontraktojë ose të thërrasë një palë të tretë për kryerjen e ndonjë pjese të kontratës, nuk e çliron kontraktorin nga përgjegjësia e tij.

BKT rezervon të drejtën të anulojë procesin e shprehjes së interesit, të ndryshojë sasinë ose shërbimet e kërkuara në këtë Kërkesë për Propozim.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **30.11.2023, ora 12:00.**

**Departamenti i Prokurimeve**

Aneks 1

Oferta financiare

Nr.	Përshkrimi	Çmimi me TVSH	Komente (nëse ka)
1	Qira /mujore e ambientit		

\*Çmimi i ofertuar duhet të përfshijnë TVSH, dhe çdo takse tjetër të aplikueshme.

\*Çmimi i ofertuar duhet të jetë i pandryshueshme përgjatë gjithë vlefshmërisë së ofertës dhe kontratës.

\* BKT ka të drejtën e ndryshimeve deri në kontraktimin e kompanisë fituese bazuar në nevojat e saj.